

VENDIM
Nr. 343, datë 23.5.2012

PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE, PËRFAQËSUES TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
NË KËSHILLIN MBIKËQYRËS TË AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË KREDIVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 1 të ligjit nr. 8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e anëtarëve, përfaqësues të Këshillit të Ministrave, në këshillin mbikëqyrës të Agjencisë së Trajtimit të Kredive, si më poshtë vijon:

- Znj. Roza Nauni ekonomiste;
- Z. Hasan Metuku jurist;
- Z. Xhentil Demiraj ekonomist.

2. Anëtarët e caktuar në pikën 1 të këtij vendimi , e ushtrojnë funksionin deri në përfundim të afatit të veprimtarisë së Agjencisë së Trajtimit të Kredive, sipas nenit 23 të ligjit nr. 8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, të ndryshuar. Në çdo rast, ata nuk mund ta ushtrojnë këtë funksion për një mandat mbi tre vjet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha